

VENDIM
Nr. 774, datë 12.12.2022

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 71, DATË 3.2.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE
‘VËLLEZËRIT MASHA’, MAZHË E VOGËL, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUBQ,
BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 71, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Krujë, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 58 204 175 (pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Masha”, Mazhë e Vogël, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”;

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku